



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:021186

Datë: 26.07.2018

Numri i dokumentit: 00090501

P. nr.923/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarit P. R. nga fsh.Jahoc K Gjakovë, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 te KPRK-ës, sipas Aktakuzës se Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP.nr.1838/17 të datës 26.12.2017, gjatë shqyrtimit gjyqësor më datë **13.07.2018**, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë - Prokurorit Bajram Kryeziu, përf. të autorizuar te dëmtuarës L. M. si dhe të akuzuarit P. R. , mori dhe të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **P. R.** nga fsh. J. K Gjakovë , me banim te përkohshëm ne Zvicër ,i biri i U. dhe i nënës Z. e gjinisë F. , data e lindjes ne Gjakovë , ka te kryer shkollën fillore, i pa punë ,i gjendjes se dobët ekonomike , shqiptar ,shtetas i R. Kosovës , i martuar at i 2 fëmijëve, me nr.ID

Bazuar në nenin 363 par. 1 pika 1.1 të KPPK-së:

REFUZOHET AKUZA

Sepse :

- **Nga data e pa vërtetuar e gjere me dt.28.08.2017**, ne shtëpinë e tij e cila ndodhet ne fsh. J. K Gjakovë, me qellim qe vetit ti sjellë përfitim pasuror, ne mënyrë te kundërligjshme, ka shfrytëzuar energjinë elektrike ne atë mënyrë qe pa njehsor elektrik përmes kabllor është lidhur direkt në rrjetin elektrik ashtu qe ka pamundësuar kështu regjistrimin e saktë te energjisë elektrike te shënuar ,me ç ‘rast ndërmarrjes se dëmtuar K. divizioni ne Gjakovë i ka shkaktuar dem ne shume prej 131.15 euro .

-me çka do të kishte kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore DP në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1838/17 të datës 26.12.2017, ka akuzuar të akuzuarin P. R. nga fsh. J. K Gjakovë, për shkak të veprës penale shfrytëzimi paautorizuar i energjisë elektrike nga neni 61/1 nen par1.1 LEE nr.05/L-085.

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt. 13.07.2018 ,Prokurori i shtetit ,Bajram Kryeziu lexoi aktakuzën PP.nr. 1838/17 të dt. 26.12.2017, me ç ‘rast prokurori deklaroi se e bënë rikualifikimin e veprës penale nga vepra penale shfrytëzimi paautorizuar i energjisë elektrike nga neni 61/1 nen par1.1 LEE nr.05/L-085 dhe duhet te jete veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

I akuzuari P. R., gjatë shqyrtimit fillestar me dt.13.07.2018, duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se nuk e pranon për te cilën akuzohet sipas aktakuzës se ri kualifikuar me qene se ne shtëpinë ne te cilën është bere ose është konstatuar manipulimi e shfrytëzon vëllai im M. R. i cili edhe ka bere pagesën e demit ,me vëllain jemi te ndarë qe 8 vite dhe unë posedoj me një njehsor tjetër elektrik .

Perf. i autorizuar i te dëmtuarës L. M. deklaroi e si pale e dëmtuar e njoftojmë gjykatën se pas përpilimit te kallëzimit penal për këtu te akuzuarin P. R. ,K.- distrikti ne Gjakovë ka siguruar prova te reja ku vërtetohet se shfrytëzues i këtij njehsori nuk është këtu i akuzuari por vëllai i tij , M. R. , dhe për këtë gjendje faktike është njoftuare PTH ne Gjakovë me parashtrese te pranuar me dt. 17.01.2018. Me dt. 16.01.2018, vëllai i te akuzuari M. R. ka bërë pagesën e rikthimit te humbjeve dhe është deklaruar se shfrytëzues i këtij njehsori është vet ai e jo këtu i akuzuari .Duke qene se gjendemi në një situatë te tillë e dëmtuara K.-Distrikti në Gjakovë, tërhiqet nga ndjekja penale respektivisht kallëzimi penal me mundësi shqyrtimi qe te ngritet një kallëzim i ri penal për te dyshuarin .

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu ,deklaroi se ne këtë fazë te procedurës pas deklarimit te perf. te autorizuar te dëmtuarit si dhe parashtrese nga vete i dëmtuari dt. 17.01.2018, u vërtetua se i dyshuari P. R. nuk është kryes i kësaj vepre penale pasi qe i njëjti ndodhet me punë ne boten e jashtme ne Zvicër dhe bashkësinë familjare me vëllain e tij Marashin e kanë bere para 8 vite , ky tani jeton ne shtëpinë e tij ,ndërsa M. R. jeton ne shtëpinë qe njehsori ka qene ende ne emër te dyshuarit P. R. ,ndërsa sipas shkresës te marr nga perf. i autorizuar i te dëmtuarës K. Distrikti K.- ne Gjakovë njoftohemi se te njëjtit tërhiqen nga kallëzimi penal te ushtruar ndaj P. R.,pasi qe ne bazë te vërtetimit te gjendjes faktike ne teren shihet se shfrytëzues është M. R. i cili ka bere edhe kompensimin e demit ne tërësi ,andaj edhe ne tërhiqemi nga ndjekja penale për te akuzuarin P. R. ne mungesë te provave se ka kryer veprën penale.

Pasi që Prokurori është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit , Gjykata në bazë të nenit 363 par. 1 pika 1.1 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 454 par. 1 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P nr.927/17 të dt. 13.07.2018.

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës se Apelit ne Prishtinë.Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj GjyKate.